

KOSOVO



KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS

KËSHILLI PËR ARBITRAZH SPORTIV (KAS)



**RREGULLORE
E KËSHILLIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV**

Prishtinë, Shkurt 2025

Në mbështetje të Ligjit për Sport NR. 08/L-277 dhe Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Asambleja e KOK-ut në përputhje me nenin 5, paragrafi 2, pika b (xiii) në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 7 Shkurt 2025, aprovon këtë:

Rregullore e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi, fushëveprimi dhe selia

1. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv të Kosovës (KAS) është organi më i lartë i gjyqësisë Sportive në vend që vepron në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK).
2. Kjo Rregullore përcakton përbërjen, mënyrën e zgjedhjes, kompetencën, procedurën e punës, organizimin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KAS”), kompetencën dhe përbërjen e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, Arbitrave dhe Ndërmjetsuesve, rregullat e Arbitrazhit, shpenzimet paraprake për hapjen e procedurës në (“KAS”) dhe shpenzimet tjera.
3. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sportistëve, personave juridik si dhe fizik të cilët kryejnë aktivitete sportive, Komitetit Olimpik dhe anëtarëve të saj, Federatave sportive, Klubeve sportive, Shoqatave dhe organizatave të tjera në fushën e sportit, përveç nëse me ndonjë ligj tjetër nuk është paraparë zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve (si dhe juridiksioni ekskluziv) nëpërmjet ndonjë Gjykate të Republikës së Kosovës.
4. KAS e ka selinë në Prishtinë, Rr. Agim Ramadani – Shtëpia e Sporteve nr.253
5. KAS e ka vulën e vet të rrumbullakët, me mbishkrimin si në vijim: Këshilli i Arbitrazhit Sportiv – Komiteti Olimpik i Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv ("KAS") nënkupton organin e pavarur gjyqësor Sportiv, i cili zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e KOK;
 - 1.2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ("GJAS") nënkupton organin prej një (1) Arbitri ose tre (3) Arbitra të cilët janë emëruar të vendosin për një mosmarrëveshje;
 - 1.3. Ndërmjetësi nënkupton personin e licencuar për ndërmjetësim i cili mund të caktohet nga palët para se të fillojë procedura e rregullt në GJAS;
 - 1.4. Paditësi tregon palën që fillon procedurën e Arbitrazhit, përfshirë një ose më shumë paditës, nëse ka të tillë;
 - 1.5. I padituri nënkupton palën ndaj së cilës ka filluar procedura e Arbitrazhit si dhe mund të përfshijë një ose më shumë të paditur, nëse ka të tillë;
 - 1.6. Një palë ose palët do të thotë paditësi dhe i padituri;
 - 1.7. Padia është dokument i hartuar nga paditësi, me të cilën fillohet procedura e Arbitrazhit në KAS.

Neni 3

Parimet e përgjithshme dhe kompetenca

1. Misioni i "KAS" është zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit nëpërmjet Arbitrazhit. "KAS" e ushtron këtë funksion me anën e dhënies së Vendimeve të Arbitrazhit, të cilat janë të njohura nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, Ligji për Sport NR. 08/L-277, Statuti i KOK- ut dhe kanë të njëjtën forcë ligjore dhe zbatueshmëri, sikur të ishte një gjykatë shtetërore.
2. "KAS" në kuadër të kompetencave të tij, ka funksion legjitim të ndihmojë palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre në mënyrë parimore, nëpërmjet:
 - 3.2.1. Ndërmjetësimit;
 - 3.2.2. Interpretimeve ligjore, dhe
 - 3.2.3. Këshillave.
3. KAS i ushtron funksionet e tij të lartëpërmendura, duke respektuar parimet e pavarësisë, barazisë, konfidencialitetit, paanshmërisë si dhe duke siguruar përfaqësimin e barabartë dhe të drejtë të palëve në procedurë.

4. KAS respekton parimet e themelore të Qeverisjes së Mirë, Kodin e Lëvizjes Olimpike për Parandalimin e Manipulimit të Garave, Manualin e Komitetit Ndërkombëtar Paraolimpik, Kodin e Sportit të Arbitrazhit "CAS".
5. KAS bashkëpunon me Këshillin Ndërkombëtar të Arbitrazhit Sportiv, me Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv, bashkëpunon me Komitetin Olimpik dhe Paraolimpik të Kosovës, Komitetin Olimpik si dhe Paraolimpik Ndërkombëtar.

Neni 4

Zbatimi i Dispozitave të Rregullores

1. KAS bën shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në përputhje me këtë Rregullore për çështjet si më poshtë:
 - 1.1. Mosmarrëveshjeve në mes KOK dhe anëtarëve të saj, Federatave, Klubeve, Shoqatave, organeve drejtuese të tyre, si dhe organizmave të tjerë sportiv;
 - 1.2. Mosmarrëveshjeve të lindura mbi masat disiplinore përfshirë por pa u kufizuar në përdorimin e dopingut apo substancave të tjera të ndaluara, shkeljet disiplinore përgjatë aktiviteteve sportive;
 - 1.3. Mosmarrëveshjeve të lindura nga kontratat ndërmjet palëve të cilat njohin kompetencën e KAS-it, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përfshirë, por pa u kufizuar në ekzekutimin e kontratave, sponsorizimin e aktiviteteve sportive, shitjen e të drejtave televizive; dhe
 - 1.4. Mosmarrëveshjeve lidhur me përgjegjësitë civile në fushën e sportit përfshirë, por pa u kufizuar në aksidentimin e një sportisti, dëmtimin e pronës së klubeve sportive, dëmtimin e imazheve të klubeve sportive apo federatave.
2. Çdo person fizik apo juridik, i cili ka zotësinë juridike për të vepruar mund t'i drejtohet KAS-it, për kontestet nga fusha e Sportit si Sportistët, Klubet, Federatat sportive, Organizatat dhe Shoqatat sportive, organizuesit e aktiviteteve sportive, sponsorizuesit, kompanitë televizive etj.
3. Dispozitat e kësaj Rregullore aplikohen për të gjitha mosmarrëveshjet që hyjnë në kompetencë të KAS-it.

KAPITULLI II

KËSHILLI I ARBITRAZHIT SPORTIV

Neni 5

ORGANIZIMI I KAS

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që lindin në fushën e Sportit mes organizatave sportive dhe organizatave tjera të lidhura me Sport bëhet përmes Arbitrazhit sportiv për të cilën është titullar dhe kompetent Këshilli i Arbitrazhit Sportiv të Kosovës.
2. Në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv vepron edhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv e përbërë nga Arbitrat dhe ndërmjetësit.
3. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është organ kolegjal që drejton, autorizon dhe kryen mbikëqyrjen e përgjithshme të punës së Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe detyrave tjera të parapara me ligj.
4. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (GJAS) është tribunal i formuar enkas për çdo mosmarrëveshje që zgjidhet përmes arbitrazhit dhe që përbëhet nga anëtarët e përzgjedhur nga lista e Arbitrave dhe Ndërmjetësve.
5. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv ka detyrën kryesore të garantojë dhe ruaj pavarësinë, ligjshmërinë e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe të drejtat e palëve. Për këtë qëllim, KAS kujdeset për administrimin dhe financimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv do të ketë kodin e veçantë buxhetor në kuadër të KOK;
6. KAS bënë interpretimin ligjor të Rrregullores, jep mendime dhe instruksione profesionale (jo të obligueshme) kur kërkohet nga palët e autorizuara për këtë;
5. Anëtarët e KAS, Arbitrat dhe Ndërmjetësit nuk mund të lidhin kontrata pune sipas Ligjit të punës por puna e tyre kompenzohet si punë dytësore.

Neni 6

Përbërja, mandati dhe kushtet për tu zgjedhur anëtar

1. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv i zgjedh Asambleja e Përgjithshme e KOK për një mandat pesë (5) vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Kandidati për t'u zgjedhur anëtar në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv, Arbitër apo ndërmjetës duhet t'i plotësoj kriteret si në vijim:

6.2.1. të jetë shtetas i Kosovës dhe të jetë i dëshmuar për etikën profesionale, drejtësinë, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë;

6.2.2. të jetë jurist me së paku dhjetë (10) vite të përvojës së punës profesionale;

6.2.3. të ketë përvojë dhe njohuri për sportin kosovar përfshirë legjislacionin e fushës së sportit dhe legjislacionin e ndërlidhur me këtë fushë;

6.2.4. Të mos jetë i dënuar për vepra penale me dashje dhe

6.2.5. Të mos jetë anëtarë i ndonjë partie politike.

3. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit nuk mund të jenë pjesë e listës së Arbitrave ose Ndërmjetësve të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv dhe as nuk mund të jenë avokatë ose përfaqësues të palëve në procedurë në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv.

4. Anëtarët e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv kanë të drejtën e kompensimit financiar për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Mjetet për punën dhe veprimtarinë e Këshillit të Arbitrazhit dhe Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv sigurohen nga të hyrat për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve si dhe nga buxheti i KOK në një kod të veçantë financiar.

Neni 7

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv

1. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv funksionon në kuadër të Këshillit të Arbitrazhit Sportiv dhe është përgjegjëse për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve në fushën e sportit dhe antidopingut.

2. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv vendos për kontestet në fushën e sportit që lindin në dhe mes anëtarëve të KOK, KPK, Federatave përkatëse të sportit, të Klubeve sportive, Federatave e shoqatave shumë sportive, dhe personave tjerë fizik dhe juridik të përfshirë në sistemin e sportit, për të cilat konteste janë shtjerrë ose nuk ekzistojnë mjete të tjera të mbrojtjes juridike në kuadër të procedurave të brendshme të atyre organizatave dhe nëse ekziston një marrëveshje mes palëve që mosmarrëveshja e tyre të zgjidhet përmes arbitrazhit sportiv në KAS.

3. Vendimet e GjAS janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme ndaj palëve në Arbitrazh.

Neni 8

Arbitrat dhe ndërmjetësit

1. Arbitrat dhe Ndërmjetësit e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik. Numri i Arbitrave duhet të jetë pesëmbëdhjetë (15).
2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e njëjta sikurse anëtarët e KAS të parapara me nenin 6 të kësaj Rregulloreje.
3. Përgjithësisht, Ndërmjetësit duhet të jenë të çertifikuar sipas Ligjit përkatës për Ndërmjetësim. Numri i ndërmjetësve duhet të jetë pesë (5).
4. Ndërmjetësi mund të udhëheq i vetëm procedurën e ndërmjetësimit, nëse palët janë pajtuar paraprakisht dhe nëse vlera e kontestit mund të zërthehet në vlerë monetare deri 4000 euro.
Ndërmjetësi nuk mund të jetë i caktuar Arbitër i kontestit të cilin ai e ka ndërmjetësuar më parë.
5. Një numër i kufizuar i Arbitrave dhe Ndërmjetësve mund të rezervohen për ekonomistë që përshtatshëmrisht i plotësojnë kushtet e parapara.

Neni 9

1. Propozimet për t'u zgjedhë anëtar i KAS-it i bëjnë Federatat sportive në Asamblenë e Përgjithshme të KOK.
2. Secila Federatë sportive anëtare e KOK, mund të propozoj një kandidat për anëtar të KAS-it, për Arbitër apo ndërmjetës, të specifikuara në listë dhe nëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara.
3. Nëse një anëtar i KAS, Arbitër apo Ndërmjetës nuk mund të kryej funksionin e vet, KAS me propozim të Kryetarit përcaktojnë anëtarin e ri për pjesën e mbetur të mandatit. Bordi i KOK duhet të miratojë këtë ndryshim.

Neni10

Organet e "KAS"

1. Organet e KAS janë:
 - 1.1. Kryetari, Nënkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i KAS;
 - 1.2. Arbitrat dhe Ndërmjetësit;
 - 1.3. Gjykata e Arbitrazhit Sportiv;
 - 1.4. Sekretaria e KAS.

Neni 11

Kryetari i KAS

1. Puna e KAS menaxhohet nga Kryetar i KAS.
2. Kryetari i KAS zgjedhet nëpërmjet votimit të fshehur nëse nuk përcaktohet ndryshe nga anëtarët e tij. Zgjedhja bëhet me shumicë votash për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 12

Kompetencat e Kryetarit të KAS

1. Kryetari i KAS-it kryen ka këto kompetenca:
 - 1.1 Të emërojë Arbitrin, Ndërmjetësin ose Kryetarin e GjAS në rastet e parashikuara me këtë Rregullore;
 - 1.2 Propozon përjashtimin dhe zëvendësimin e Arbitrit apo ndërmjetësit në përputhje me nenin 29 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.3 Dorëzon një program dhe raport vjetor të KAS në Asamblenë e Përgjithshme të KOK;
 - 1.4 Kryen detyra të tjera, të përcaktuara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Nënkryetari i KAS

1. Nënkryetari i KAS-it zëvendëson Kryetarin e KAS kur ai nuk mund të kryen detyrat e tij, si dhe në rastet kur Kryetari i KAS-it delegon kompetencat e tij te ai;
2. Nënkryetari i KAS-it zgjedhet nëpërmjet votimit të fshehur nëse nuk përcaktohet ndryshe nga anëtarët e tij. Zgjedhja bëhet me shumicë votash për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 14

Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it

1. KAS ka një Sekretar të Përgjithshëm.
2. Sekretar i Përgjithshëm mund të zgjedhet njëri nga anëtarët e KAS.
3. Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it zgjedhet nga KAS nëpërmjet votimit të fshehur nëse nuk përcaktohet ndryshe nga anëtarët e tij. Zgjedhja bëhet me shumicë votash për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 15

Kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm të KAS

1. Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it kryen punë administrative dhe organizative si në vijim:
 - Merr përsipër veprimet administrative për themelimin e GjAS dhe përgatitë materiale për zgjidhjen e një mosmarrëveshje në një rast të veçantë;
 - Kujdeset për ekzekutimin e duhur të vendimeve dhe urdhërave të GjAS;
 - Përgatit raportin vjetor të punës, pasqyrat financiare vjetore, harton planin e punës dhe atë financiar të cilat i'a dorëzon Kryetarit të KAS-it;
 - Kryen detyra të tjera, të përcaktuara me aktet e KAS-it, si dhe detyra tjera që i delegon KAS-i.
 - Në rast të pezullimit të përkohshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të KAS-it, Kryetari i KAS-it do të emërojë një person për të zëvendësuar Sekretarin e Përgjithshëm të KAS nga radhët e anëtarëve të KAS-it.
2. Puna e Sekretarit të Përgjithshëm, KAS-it dhe GjAS-it mbështetet nga Sekretaria e KAS-it. Në kuadër të Sekretarisë së KAS-it mund të angazhohen persona përgjegjës për çështje administrative, financiare dhe ligjore për të siguruar mbarëvajtjen e punës së këtyre organeve.

Neni 16

Kompenzimi për anëtarët e KAS

1. Për kompenzimin e anëtarëve të KAS-it dhe pozitave tjera në KAS vendoset nga buxheti i alokuar për KAS.
2. Kompenzimi i anëtarëve të GjAS përcaktohet me vendim të BE të KOK sipas propozimit të KAS.

Neni 17

Gjykata e Arbitrazhit Sportiv (GJAS)

1. GjAS përbëhet nga një ose tre Arbitra të emëruar nga radhët e anëtarëve të KAS.
2. Palët mund të vendosin për një Ndërmjetësues apo Arbitër të përbashkët. Në rastet kur KAS vendosë që një rast të gjykohet nga një Arbitër ai/ajo emërohet nga Kryetari i KAS.

3. Kur KAS vendosë që GjAS të ketë tre Arbitra për rastin, dy Arbitra do të propozohen nga palët në mosmarrëveshje, ndërsa kryetarin e GjAS e propozon Kryetari i KAS.
4. Arbitrat e GjAS nuk duhet të kenë konflikt interesi me ndonjërin nga palët në mosmarrëveshje.

Neni 18

Përgjegjësitë e tjera të Organeve të KAS

1. Kryetari, Nënkryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it ndërmarrin aktivitete të nevojshme për zhvillimin dhe promovimin e KAS-it në Republikën e Kosovës.
2. Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it dhe anëtarët e tjerë të KAS respektojnë legjislacionin e Republikës së Kosovës që i referohet Sportit dhe Arbitrazhit, si dhe monitorojnë zbatimin e kësaj Rregulloreje. Të njëjtit, kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin të kësaj Rregullore si dhe rregulloreve tjera në kompetencë të KAS-it.
3. Anëtarët e KAS organizojnë dhe zhvillojnë seminare, këshilla, trajnime, tryeza diskutimi dhe ngjarje të tjera për publikun e gjerë dhe komunitetin sportiv.
4. Anëtarët e KAS-it, marrin pjesë në takimet shkencore dhe profesionale në vend dhe jashtë vendit, të përgatisin dhe të publikojnë dokumente profesionale dhe shkencore lidhur me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të sportit përmes KAS.
5. Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i “KAS” do të mbajnë kontakte të rregullta me Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS) në Lausanne, Zvicër.
6. Me kërkesë të KOK-ut, MKRS-së dhe federatave sportive KAS jep këshilla juridike rreth harmonizimit të Statuteve të tyre me Ligjin për Sport, Statutin e KOK-ut, Statuteve dhe akteve normative tjera të brendshme me Statutet dhe aktet normative të Federatave ndërkombëtare dhe kodet e etikës.

Neni 19

Lista e Arbitrave dhe Ndërmjetësve

1. KAS-i ka një listë prej 15 Arbitrave dhe 5 ndërmjetësve, të zgjedhur në Asamblenë Zgjedhore të KOK-ut dhe të njëjtën e publikon në faqen zyrtare të KOK-ut dhe KAS-it.
2. Sekretaria e KAS mban listën e përditësuar të Arbitrave apo Ndërmjetësve të zgjedhur dhe emëruar në GjAS për të gjitha rastet.

KAPITULLI III – RREGULLAT E ARBITRAZHIT

Neni 20

Kompetenca dhe përbërja e KAS

1. Fillimi i procedurës në KAS fillon me parashtrimin e padisë lidhur me një mormarrëveshje në mes të dy apo më shumë palëve.
2. Mosmarrëveshja konsiderohet atëherë kur:
 - 1.1. ekziston mosmarrëveshje në një raport midis palëve;
 - 1.2. palët dështojnë në përmbyshjen e marrëveshjes së arritur gjatë procedurës së Arbitrazhit, me të cilën është menduar se është zgjidhur mosmarrëveshja në KAS.
2. Një padi pranohet nga KAS vetëm në rastet kur të gjitha mjetet juridike në dispozicion janë shterur, në të cilën paditësi dëshmon ekzistimin e mosmarrëveshjes.
3. Gjatë procedurave që lindin si pasojë e mosmarrëveshjeve midis dy apo më shumë palëve, GJAS-i do të bëjë përpjekje të zgjidhë mosmarrëveshjen në mënyrë paqësore.

Neni 21

Kundërshtimi ndaj pranueshmërisë së padisë dhe kompetencës së KAS

1. Çdo kundërshtim nga palët ndaj pranueshmërisë së padisë dhe kompetencës së KAS duhet të dorëzohet jo më vonë se seanca e parë dëgjimore. Në rastet kur procedura kryhet pa mbajtjen e seancës dëgjimore, ky kundërshtim duhet të dorëzohet jo më vonë se kur dorëzohet përgjigja në padi. Kundërshtimi duhet të dorëzohet me shkrim në KAS.
2. Vetëm KAS mund të vendosë lidhur me kundërshtimin e kompetencës së KAS.

Neni 22

Përzgjedhja e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (GJAS)

1. GjAS përbëhet nga 1 ose 3 Arbitra.
2. Arbitrat zgjidhen dhe emërohen nga lista e arbitrave të KAS.
3. Numri i Arbitrave përcaktohet nga marrëveshja e palëve. Në mungesë të marrëveshjes së palëve për numrin e Arbitrave, Kryetari i KAS përcakton numrin e Arbitrave të GjAS, varësisht nga natyra dhe ndërlikueshmëria e rastit.

4. Paditësi përzgjedh një Arbitër nga lista e Arbitrave apo mund të propozojë një ndërmjetës nëse edhe pala tjetër pajtohet. Në rast se Paditësi nuk ka propozuar emrin e Arbitrit të GjAS në padinë e parashtruar në KAS, Paditësi do të propozojë emrin e Arbitrit të GjAS brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i KAS për propozimin e Arbitrit të GjAS.
5. I padituri përzgjedh njërin Arbitër nga lista e Arbitrave, mund të pajtohet për një Arbitër të përbashkët apo edhe për një ndërmjetës të dakorduar me paditësin, brenda afatit për parashtrimin e përgjigjes në padi.
6. Nëse palët në procedurë kanë përcaktuar nga një Arbitër sipas procedurës në fuqi, Kryetari i GjAS propozohet dhe emërohet nga Kryetari i KAS për rastin konkret.
Nga ky rregull bëhet përjashtim në rast të konfliktit të interesit. Në rast se KAS konstaton se anëtari i përzgjedhur ose i emëruar ka konflikt interesi me rastin në fjalë, atëherë duhet emëruar anëtari tjetër për Arbitër për rastin e njëjtë.
7. Në rast se asnjëra nga palët në procedurë, ose njëra palë nuk ka përzgjedhur Arbitrin nga lista e Arbitrave, propozimin dhe emërimin për Arbitrin e bënë KAS.
8. Çdo Arbitër i përzgjedhur do të veprojë në përputhje të plotë me këtë Rregullore.

Neni 23

Caktimi i një Arbitri

1. Një Arbitër individual mund të veprojë pas emërimit të KAS apo nëse palët janë pajtuar për një arbitër individual.
2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, palët janë të detyruara të paraqesin tek Sekretari i Përgjithshëm, emrin e një Arbitri individual, jo më vonë se dorëzimi i përgjigjes në padi.
3. Nëse palët nuk e paraqesin emrin e Arbitrit në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, në atë rast Sekretari i Përgjithshëm i KAS do t'i paraqesë palëve listën e Arbitrave me një thirrje që brenda 24 orëve secila nga palët duhet ta zgjedh një Arbitër. Nëse zgjedhin të dyja palët të njëjtin person për Arbitër, ai person do të emërohet si Arbitër i vetëm;
4. Nëse palët nuk zgjedhin të njëjtin person si një Arbitër nga lista e propozuar, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, atëherë Arbitri individual në GJAS do të emërohet sipas nenit 22 të kësaj Rregulloreje.

Neni 24

Emërimi i Ndërmjetësit

Pala paditëse ka të drejtë të kërkojë nga KAS caktimin e ndërmjetësit nga lista e Ndërmjetësuesve dhe kjo mund të miratohet nëse edhe pala e paditur pajtohet me propozimin dhe atë në afatin e përcaktuar prej 10 ditësh.

Nëse pala e paditur nuk përgjigjet në këtë kërkesë atëherë konsiderohet se kërkesa është refuzuar dhe fillon procedura e Arbitrazhit.

Poashtu, nëse palët nuk arrijnë të merren vesh nëpërmjet ndërmjetësit, atëherë paditësi i drejtohet KAS për procedurën e rregullt të Arbitrazhit e cila fillon në momentin kur bëhet padia dhe pagesa respektive e taksës. Në këtë rast, GJAS nuk merr parasysh asnjë element të procedurës së ndërmjetësit dhe konsideron se ajo nuk ka kurfarë efekti juridik.

Në rast të kërkesës për Ndërmjetësim, paditësi paguan gjysmën e shumës së taksës së paraparë për Arbitrazh dhe mëditjet e ndërmjetësuesit të caktuar nga KAS.

Neni 25

Emërimi i Arbitrave në rastin e paditësve apo të disa të paditurve

1. Nëse disa paditës paraqiten në një mosmarrëveshje, në të njëjtën cilësi ose të të paditurit, ata janë të detyruar të arrijnë një marrëveshje për caktimin e një Arbitri të përbashkët.
2. Nëse palët nga paragrafi 1 i këtij neni nuk caktojnë një Arbitër të përbashkët, përzgjedhja e Arbitrit do të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje. Nëse një person zgjidhet nga të gjitha palët, ai person do të jetë i emëruar për Arbitrin e përbashkët të paditësve apo të paditurve.
3. Nëse Arbitri i përbashkët nuk mund të emërohet në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Arbitri emërohet nga Kryetari i KAS.

Neni 26

Njoftimi për emërimin dhe pranimin e emërimit

1. Sekretari i Përgjithshëm i KAS njofton palët për arbitrat e zgjedhur nga palët brenda 3 ditëve nga dita kur emri i tyre i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm.
2. Nëse brenda 5 ditëve nga data e pranimin të njoftimit, Arbitri i emëruar nuk ka paraqitur një deklaratë që pranon emërimin dhe një deklaratë të paanshmërisë dhe pavarësisë, konsiderohet se ka refuzuar emërimin në cilësinë e arbitrit në GjAS.
3. Nëse Arbitri refuzon emërimin nga palët, Sekretari i Përgjithshëm i KAS do të thërrasë palën që ka emëruar Arbitrin, brenda 3 ditëve për të emëruar një person tjetër si arbitër në GjAS.
4. Sekretari i Përgjithshëm njofton palët për pranimin e emërimit të arbitrit tjetër brenda 3 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 27

Paanshmëria dhe pavarësia e Arbitrave

1. Çdo person që mund të bëhet Arbitër duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur. Çdo individ që është pjesë e një procedure në KAS, në rast se vëren një dukuri apo ka dyshim të justifikuar lidhur me detyrimin e paanshmërisë dhe pavarësisë së arbitrit, do të njofton organet e KAS.
2. Me rastin e pranimin të emërimit, Arbitri duhet të paraqesë dhe nënshkruajë një deklaratë të paanshmërisë dhe pavarësisë. Në deklaratë, arbitri duhet të zbulojë dhe deklarojë ato rrethana që një palë e tretë e arsyeshme do t'i konsideronte si rrethana që prekin paanshmërinë dhe/ose pavarësinë e arbitrit dhe konfliktin e interesit, dhe në veçanti:
 - a) çdo marrëdhënie me palët, ose çdo person tjetër që merr pjesë në procedurën e arbitrazhit;
 - b) nëse ekziston një interes financiar me palët ose i tërthortë në lidhje me zgjidhjen e çështjes;
 - c) nëse ka informata konfidenciale lidhur me çështjen e mosmarrëveshjes, të cilën e ka mësuar nga burime jashtë procedurës së arbitrazhit;
 - d) rrethana të tjera me rëndësi për mbrojtjen e paanshmërisë dhe pavarësisë në procedurë.
3. Sekretari i Përgjithshëm i KAS deklaratën për paanshmëri dhe pavarësi të Arbitrave së bashku me deklaratën e pranimin të emërimit të tyre, do t'i dërgojë tek palët brenda 5 ditëve nga dita e dorëzimit të deklaratës.

Neni 28

Përfundimi i detyrës së një Arbitri në GjAS

1. Detyra e arbitrit në GjAS pushon:
 - 1.1 me nënshkrimin e vendimit të Arbitrazhit, dhe duke nënshkruar interpretimin dhe korrigjimin e dhënies së vendimit të Arbitrazhit, në rast të vendimit të pjesshëm apo vendimit plotësues;
 - 1.2 me përjashtim nga GjAS;
 - 1.3 duke nxjerrë një vendim mbi ndërprerjen e detyrës së Arbitrit për shkak të dështimit ose moszbatimit të detyrës së një Arbitri sipas kësaj Rregulloreje;
 - 1.4 për shkak të pamundësisë ose paaftësisë për të kryer detyrën për arsye e rrethana të ndryshme;
 - 1.5 dorëheqjes.

Neni 29

Përjashtimi i Arbitrit

Përjashtimi i Arbitrit mund të bëhet nga KAS nëse vërtetohet ekzistimi i rrethanave të dyshimta në lidhje me paanshmërinë dhe/ose pavarësinë, ose nëse vërtetohet konflikti i interesit për të cilin arbitri nuk e ka deklaruar në deklaratën e tij.

Neni 30

Përjashtimi i detyrueshëm i një arbitri nga GjAS

1. Arbitri përjashtohet në rastet si në vijim:
 - 1.1. nëse me të pala është në lidhje si bashkëpronar të ndonjë biznesi, kanë një debitor të përbashkët ose nëse dëgjohet si dëshmitar ose ekspert në të njëjtin rast;
 - 1.2. nëse është përfaqësues ligjor ose me prokur i ndonjë të afërmi të gjakut në vijë të drejtë në çdo shkallë, dhe në një vijë anësore në një shkallë të katërt, ose është një bashkëshort, një partner jashtëmartesor ose një i afërm deri në shkallën e dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;
 - 1.3. nëse është kujdestar, prind adoptues, kujdestar ose kujdestar i palës, përfaqësuesit ose avokat i saj ligjor i palës.

Neni 31

Procedura e përjashtimit të Arbitrit

1. Një palë që synon të kërkojë refuzimin e një Arbitri është i detyruar të paraqesë një kërkesë me shkrim për përjashtim tek Sekretari i Përgjithshëm i KAS brenda 5 ditëve nga data e gjetjes së arsyes së përjashtimit për një Arbitër.
2. Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it e paraqet kërkesën tek Arbitri të cilit i kërkohet përjashtimi, si dhe tek Kryetari i KAS-it.
3. Nëse Arbitri, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk tërhiqet dhe pala që emëroi Arbitrin nuk pajtohet me përjashtimin, vendimi lidhur me kërkesën për përjashtim do të miratohet nga KAS.

Neni 32

Dështimi në përmbushjen e detyrës së një Arbitri të GjAS

1. Nëse Arbitri, për arsye ligjore ose faktike, ose për arsye të tjera që ndërlidhen me shkeljen e reputacionit të palëve dhe sportit në Republikën e Kosovës nuk është në gjendje të kryejë detyrën e tij, detyra e Arbitrit në GjAS pushon përmes dorëheqjes nga ajo pozitë.
2. Lidhur me arsyet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, secila palë me një kërkesë të arsyetuar mund të kërkojë nga Kryetari i KAS-it të marrë një vendim për ndërprerjen e detyrës të arbitrit në GjAS.

Neni 33

Emërimi i Arbitrit të GjAS

Në rastet kur Arbitri përfundon detyrën e tij në GjAS nga rastet e sipërpërmendura apo kur vetë Arbitri tërhiqet nga detyra e Arbitrit, kur vetë palët do të vendosin të përfundojnë detyrën e Arbitrit si dhe në raste të tjera të ndërprerjes së detyrës të Arbitrit, do të emërohet Arbitri tjetër nga KAS.

Neni 34

Përsëritja e procedurës në GjAS

Nëse gjatë procedurës ndryshohet përbërja e GjAS, procedura përsëritet përveç nëse palët bien dakord ndryshe.

Neni 35

Rregullat e Arbitrazhit

1. Përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore, GjAS mund të kryejë një procedurë Arbitrazhi në mënyrën që e konsideron të jetë më e përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat dhe interesat e palëve, duke marrë parasysh secilën palë në secilën fazë të procedurës dhe duke i dhënë një mundësi të caktuar për të paraqitur faktet, pretendimet ligjore dhe kërkesat.
2. GjAS mund të kërkojë nga KAS që të vendosë edhe pa dëgjimin e palëve nëse ka argumente të mjaftueshme dhe të pakontestueshme për të vendosur për kontestin e caktuar.
3. Të gjitha parashtresat, dokumentet dhe informacione të tjera që një palë duhet t'i dorëzojë në GjAS, do t'i dorëzohen edhe palës së kundërt. Çdo raport i ekspertëve do t'u dorëzohet palëve, si dëshmi e një dokumenti në bazë të të cilit GjAS mund ta bazojë vendimin e saj.

Neni 36

Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit për mbajtjen e seancave të GjAS është Prishtina.

Neni 37

Gjuha e procedurës

1. Procedura do të kryhet në gjuhën shqipe apo në gjuhë tjetër zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Të gjitha provat dhe deklaratimet në procedurë që nuk janë në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura duhet të jenë paraqitura në origjinal dhe me një përkthim zyrtar (përkthyes i licencuar gjyqësor) në gjuhën në të cilën është duke u zhvilluar procedura.

Neni 38

Dorëzimi i komunikimeve me shkrim

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe:
 - 1.1 Komunikimi me shkrim do të konsiderohet se është pranuar në ditën kur do t'i dorëzohet personit të cilit i është adresuar, kur do t'i dorëzohet në selinë e tij, vendbanimin e përhershëm apo me adresë postare. Nëse asnjë nga këto vende nuk mund të përcaktohen pasi të jetë bërë një vlerësim i arsyeshëm, komunikimi me shkrim do të konsiderohet se është marrë duke e dorëzuar atë tek adresa

e fundit e njohur e të adresuarit, me një letër rekomande, përmes e-mailit, telegramit, ose telefon, në qoftë se data kur duhet të jepet deklarata me shkrim se është pranuar ose ndryshe, me anë të së cilës mund të përcaktohet se është bërë përpjekje për dorëzim;

- 1.2 Të gjitha komunikimet me shkrim duhet të dorëzohen tek Sekretari i Përgjithshëm i KAS, i cili pastaj i paraqet të gjitha tek palët dhe GjAS;
2. Dorëzimi i komunikimit me shkrim do të konsiderohet se është përmbushur edhe atëherë kur pala ose përfaqësuesi i saj refuzon ta pranojë atë shkresë që është e adresuar për të.

Neni 39

Fillimi i procedurës së Arbitrazhit

1. Procedura e Arbitrazhit fillon me padi, e cila dorëzohet në KAS.
2. Padia duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:
 - a) emri i plotë dhe të dhënat e palëve (adresat e palëve, telefonat, faks, adresë e-mail);
 - b) objekti i kontestit;
 - c) bazën ligjore të padisë;
 - d) faktet mbi bazën e të cilave bazohet kërkesa;
 - e) provat dhe dokumentet mbështetëse;
 - f) emri i arbitrit të propozuar nga pala;
 - g) vlerën e kërkesëpadsisë, nëse ka të tillë;
 - h) nënshkrimi i aplikuesit, ose nënshkrimi elektronik.
3. Padia, përgjigjja në padi, shtojcat e padisë, parashtresat, së bashku me dokumentet e tjera plotësuese do të dorëzohen në numër të mjaftueshëm kopjesh për të gjitha palët në procedurë, Arbitrat e GjAS dhe KAS-in.

Neni 40

Afati për përgjigje në padi

1. Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it, pas pranimi dhe shqyrtimit të padisë në KAS, të paditurit i'a dërgon njoftimin për përgjigje në padi brenda afatit prej 7 ditësh.
2. Afati për përgjigje në padi është 10 ditë nga data e njoftimit.
3. Nëse padia nuk është e plotë dhe nuk i përmbanë të gjitha elementet, Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it do t'ia kthejë padinë paditësit dhe do të përcaktojë një afat shtesë prej tre ditësh për

plotësimin e padisë. Nëse paditësi nuk vepron sipas udhëzimeve, padia do t'i dorëzohet KAS për vendosje.

Neni 41

Ndryshimi dhe plotësimi i padisë dhe përgjigjes në padi

1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe gjatë procedurës së Arbitrazhit, secila palë mund të ndryshojë ose plotësojë padinë e saj, duke përfshirë përgjigjen në padi, përveç kur KAS vendos që ndryshimi apo plotësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të zgjatjes së procedurës.
2. Në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ndryshimi dhe plotësimi i padisë dhe përgjigjes në padi mund të bëhet deri në seancën përgatitore.
3. Në çdo rast, KAS nuk do të lejojë ndryshimin apo plotësimin e padisë dhe përgjigjes në padi, për çështjet për të cilat GjAS nuk është kompetent.

Neni 42

Kundërpadia

Pala e paditur, deri në përfundimin e seancës përgatitore, mund t'i paraqesë KAS-it kundërpadinë ndaj palës paditëse.

Neni 43

Afatet

1. KAS përcakton afatet në procedurën e Arbitrazhit përveç nëse ato janë të përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Afati për parashtrimin e padisë në KAS është 21 ditë nga momenti kur pala pranon Vendimin final dhe i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Padia në KAS është mjeti i fundit i jashtëzakonshëm juridik për zgjidhjen e kontesteve.
3. Gjatë përcaktimit të afateve, KAS merr parasysh natyrën e veprimeve që duhen marrë.
4. Afatet e përcaktuara nga KAS nuk duhet të jenë më gjatë se 30 ditë. Përjashtimisht nga ky rregull bëhet në rastet kur kërkohet afat shtesë për ndërmarrjen e ndonjë veprimi të caktuar procedural.
5. Afatet llogariten me ditë, muaj dhe vite.

6. Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.
7. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj date të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati.
8. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.
9. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon KAS, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
10. Procedura duhet të finalizohet përfundimisht brenda afatit prej 3 muajsh, nisur nga dita e parashtrimit të padisë. Vetëm në raste të veçanta KAS mund të vazhdojë këtë afat.

Neni 44

Dokumentet dhe provat

1. GjAS miraton vendimin e saj në bazë të provave me të cilat administron dhe vendos vetëm për çështjen e cila iu është adresuar me padi.
2. GjAS mund të kërkojë nga palët të paraqesin dokumente dhe prova të tjera për të provuar faktet e kontestuara apo të deklaruar në padi, përkatësisht përgjigje në padi, të cilat mund të konsiderohen të rëndësishme për procedurën.
3. GjAS do të vlerësoj lirshëm provat dhe nuk do të jetë i ndikuar nga raporti i ekspertëve në procedurë.
4. Të gjitha provat dhe dokumentet e paraqitura nga njëra palë në KAS, GjAS nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KAS-it i'a dorëzon palës tjetër një kopje të dokumenteve si dhe përcakton afatin brenda të cilit pala mund të jap përgjigje me shkrim.
5. Dështimi për të dhënë një përgjigje me shkrim në lidhje me provat dhe dokumentet e dorëzuara nga pala, nuk nënkupton se pala tjetër pajtohet me përmbajtjen e atij dokumenti.

Neni 45

Ekspertët

1. Për një procedurë të caktuar, palët mund të propozojnë caktimin e një eksperti përkatës lidhur me natyrën e lëndës i cili do të përgatitë një raport të çështjes së caktuar gjatë procedurës së arbitrazhit.
2. Me kërkesë të GjAS ose palëve, eksperti i emëruar do të thirret për të shpjeguar gjetjet dhe mendimet e tij në një seancë. GjAS dhe palët janë të lira të bëjnë pyetje.
3. GjAS pas pranimit të raportit nga eksperti, të njëjtin ua dërgon palëve në procedurë.
4. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, GjAS mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për të provuar faktet, mendimet dhe çështje të tjera në GjAS.
5. GjAS njofton palët menjëherë për ekspertin e emëruar nga GjAS.
6. Palët janë të obliguara, me kërkesë të ekspertit, që t'i ofrojnë të gjitha dokumentet e nevojshme të rastit, me informacione të tjera që lehtësojnë përgatitjen e raportit të ekspertit si dhe të ofrojnë qasje në dokumentet përkatëse.
7. Me marrjen e konstatimeve dhe mendimit të ekspertit, GjAS duhet t'u jep palëve afat brenda të cilit mund të deklarohen me shkrim në lidhje me konkluzionet dhe mendimin e ekspertit.
8. Dispozitat për përjashtimin dhe mospërmblidhjen e detyrave të një Arbitri vlejnë edhe për ekspertin.
9. Kompensimi i ekspertit përcaktohet sipas rregullave të aplikueshme për kompensimin e ekspertëve në procedurën kontestimore në Republikën e Kosovës.

Neni 46

Dëshmitarët

1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, secila palë mund t'i propozoj GjAS-it të thërrasë një apo më shumë dëshmitarë që të dëgjohen në seancë.
2. Pala që dëshiron të thërrasë një dëshmitar, është i detyruar të paktën 7 ditë para mbajtjes së seancës të japë të dhënat e dëshmitarit sikurse: emrin dhe mbiemrin, adresën, me të dhënat kontaktuese.
3. GjAS do të njoftoj palën tjetër për dëshmitarin që do të merret në pyetje, si dhe për temën e dëshmisë.
4. Secila nga palët dhe GjAS mund të bëjnë pyetje drejtuar dëshmitarit.

5. Dëshmitari nuk mund të detyrohet të dënohet e as të ndëshkohet nëse refuzon të dëshmojë ose të largohet nga dëgjimi.
6. Dëshmitari mund të japë deklaratën e tij edhe në një deklaratë në formë me shkrim të nënshkruar nga vetë ai.

Neni 47

Procedura e miratuar dhe e shkruar

1. GjAS do të mbajë seanca dëgjimore nëse palët janë të pranishme dhe ata nuk janë pajtuar ndryshe.
2. KAS do të informojë GjAS, palët, dëshmitarët dhe ekspertët para seancës për datën, orën dhe vendin e mbajtjes së seancës. GjAS kur cakton një seancë përgatitore ose një seancë për shqyrtim, do të kujdeset që palët të kenë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur.
3. Nëse palët nuk bien dakord ndryshe, procedura e Arbitrazhit nuk është publike.
4. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, GjAS mundet që dëgjimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve ta bëjë përmes komunikimit me video, pa praninë fizike të dëshmitarit, ose ekspertit në ambientet ku zhvillohet procedura.

Neni 48

Procesverbalet

1. Në seancë dëgjimore dhe seancat tjera do të mbahet procesverbali.
2. Procesverbali mbahet nga një person i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KAS.
3. Procesverbali nënshkruhet nga Arbitrat, regjistruesi dhe palët, përfaqësuesit e tyre ose pjesëmarrësit tjerë.
4. Nëse njëra palë refuzon të nënshkruajë procesverbalin, deklaratimet e palëve në procedurë GjAS do të mirren përmes audio-incizimit.

Neni 49

Mbyllja e debatit

1. Kur GjAS konsideron se lënda e kontestit është shqyrtuar mjaftueshëm dhe mund të marrë një vendim, do të njoftojë palët se dëgjimi është përfunduar.
2. Pas përfundimit të seancës, GjAS merr vendimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI IV

VENDIMI I ARBITRAZHIT

Neni 50

Miratimi, forma dhe përmbajtja e vendimeve të arbitrazhit

1. GjAS merrë vendim Arbitrazhi me shumicë votash.
2. Dhënia e vendimit të GjAS duhet të nënshkruhet nga Arbitri individual i GjAS. Në procedurën e Arbitrazhit me 3 Arbitra duhet të nënshkruhen të gjithë Arbitrat. Nëse një Arbitër refuzon të nënshkruhet, atëherë nënshkrimet e shumicës së anëtarëve të GjAS janë të mjaftueshme. Ndaj Arbitrit i cili nuk ka nënshkruar Vendimin e GJAS, KAS mund të kërkojë përjashtimin e tij në Bordin Ekzekutiv të KOK.
3. Vendimi i Arbitrazhit duhet të përmbaj: hyrjen, dispozitivin, shpenzimet, arsyetimin dhe këshillën juridike.
4. Vendimet e GjAS janë të formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e palëve.
5. Vendimet e GjAS janë të obligueshme për të gjitha palët në kontest dhe përmbrohen menjëherë.
6. Kundër vendimit të GJAS, pala e pakënaqur mund të bëjë Ankësë në "CAS" të Llozanës brenda 30 ditësh, pas marrjes së vendimit.
7. Aktgjykimi i GjAS përmban datën dhe vendin e miratimit të tij.

Neni 51

Publikimet e Vendimit

1. Vendimet e KAS janë publike dhe të njëjtat publikohen në faqen e saj zyrtare.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në raste të veçanta palët mund të paraqesin kërkesë për mospublikimin e përmbajtjes së tyre.
3. Të dhënat personale në lidhje me rastin do të trajtohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, KAS vendos në lidhje me publikimin e Vendimit.

Neni 52

Gjykimi i pjesshëm dhe shtesë

Përveç gjykimit përfundimtar, GjAS mund të marrë një vendim Arbitrazhi të pjesshëm ose shtesë, nëse një pjesë e kërkesës është shqyrtuar dhe kërkohet vendimi respektiv.

Neni 53

Interpretimi dhe korrigjimi i vendimit

1. Brenda 30 ditëve nga data e pranimit të vendimit, secila palë, mund të kërkojë interpretimin e KAS-it për një vendim të Arbitrazhit apo një pjesë të caktuar të vendimit.
2. Nëse KAS konsideron se kërkesa është e arsyeshme, KAS do të lëshojë interpretimin me shkrim brenda 30 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës për interpretimin e vendimit.
3. Poashtu, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të vendimit, secila palë, mund të kërkojë nga GjAS që të korigjojë një pjesë të vendimit, për korrigjimin e ndonjë lëshimi teknik.
4. GjAS, me nismën e vet, mund ta korrigjojë një lëshim teknik brenda 30 ditëve nga data e vendimit të nxjerrë.
5. Nëse GjAS konsideron se kërkesa është e arsyeshme, korrigjimi i vendimit do të përgatitet me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për korrigjimin e vendimit.
6. GjAS nuk do të llogarisë shpenzimet për korrigjimin e vendimit.
7. Dispozitat e këtij neni zbatohen për vendimin, vendimin e pjesshëm dhe vendimin shtesë.

Neni 54

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Gjatë procedurës së Arbitrazhit, palët mund të zgjidhin mosmarrëveshjen me bisedime dhe mirëkuptim. Në raste kur palët tregojnë doza të konsiderueshme mirëkuptimi mund të kërkojnë caktimin e një ndërmjetësi, nëse jo të një Arbitri.
2. Nëse marrëveshja arrihet gjatë procedurës ose nëse të dyja palët e kërkojnë atë, GjAS do të japë një vendim Arbitrimi në bazë të marrëveshjes.
3. GjAS nuk është i detyruar të arsyetojë vendimin e miratuar në bazë të një marrëveshjeje nga palët.

Neni 55

Përfundimi i procedurës së Arbitrazhit

1. Procedura e Arbitrazhit përfundon me nxjerrjen e një vendimi të Arbitrazhit.
2. Procedura e Arbitrazhit mund të përfundojë edhe nëse:
 - 2.1. pala paditëse e tërheq padinë;
 - 2.2. nëse palët janë pajtuar të përfundojnë procedurën e arbitrazhit;
 - 2.3. nëse GjAS konstaton se vazhdimi i procedurës, nga çdo arsye nuk do të kishte efekt substancial, është bërë e panevojshme ose e pamundur.

Neni 56

Ankesa kundër vendimit të GjAS

1. Vendimet e GjAS janë të formës së prerë dhe janë të paankimueshme në Gjykata të Rregullta , përveç rasteve si në vijim:
 - 2.1. GjAS është formuar në mënyrë të parregullt;
 - 2.2. GjAS pa të drejtë ka deklaruar kompetencën e tij për gjykimin e mosmarrëveshjes;
 - 2.3. GjAS në vendimin e saj tejkalon kërkesë-padinë e palës ose nuk ka vendosur lidhur me një nga kërkesat kryesore të kërkesë padisë;
 - 2.4. nuk është respektuar barazia e palëve dhe e drejta e tyre për të paraqitur fakte dhe dokumentet përkatëse në një procedure të mbështetur në parimin e kontradiktoritetit;
 - 2.5. nëse vendimet e GjAS bien në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI V

KOSTOT PËR HAPJEN E PROCEDURAVE NË KAS

Neni 57

Shpenzimet për hapjen procedurës

1. Palët që marrin pjesë në procedurën e arbitrazhit në KAS, i mbulojnë vetë shpenzimet e procedurës, si në vijim:
 - 1.1. Shpenzimet administrative dhe materiale të procedurës duke përfshirë shpenzimet për përkthime, shpenzimet për Arbitra dhe shpenzime të tjera, si dhe

- 1.2. Taksën në vlerë prej 1500 euro për personin juridik ndërsa për personin fizik taksa në vlerë prej 700 euro. Kjo taksë nuk kthehet.
2. Pala që fillon procedurën e Arbitrazhit duhet të bëjë pagesën e nevojshme për fillimin e procedurës në xhirollogarinë e KAS.
3. Palët i paguajnë shpenzimet e procedurës së Arbitrazhit sipas vendimit të vecantë të nxjerrë nga KAS për shpenzimet e procedurës së Arbitrazhit.

Neni 58

Vendimi përfundimtar për shpenzimet e procedurës

1. Në vendimin përfundimtar të marrë në procedurën e Arbitrazhit, GjAS do të marrë vendim për shpenzimet që dalin nga procedura e Arbitrazhit.
2. GjAS përcakton shumën e kompensimit të shpenzimeve për secilën palë në procedurë si dhe për shpenzimet e veta, duke e marrë parasysh suksesin e arritur në procedurë.
3. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, shpenzimet e procedurës duhet të kompensohen nga pala që ka humbur në procedurë, (me përjashtim të taksës), përkatësisht në rast se kërkesa është miratuar pjesërisht, shpenzimet paguhen nga të dyja palët, në proporcion me pjesën e miratuar ose të refuzuar të padisë.

Neni 59

Obligimet Financiare

1. Në rastin e paraqitjes së padisë, paditësi është i detyruar të paguajë një taksë sipas nenit 56 paragrafi 1.2 të kësaj Rregulloreje si dhe të ofroj vërtetimin e pagesës në Sekretarinë e KAS-it.
2. Sekretaria e KAS-it e dorëzon padinë së bashku me provën e pagesës se detyrimet janë plotësuar dhe procedura mund të fillojë.
3. Taksa e paguar nuk është e rimbursueshme.

Neni 60

Kostoja paraprake e procedurës

1. Shpenzimet e procedurës nga neni 56 i kësaj Rregulloreje, paguhen nga paditësi paraprakisht.
2. Taksat dhe kostot tjera të procedurave propozohen nga KAS por duhet të miratohen nga BE i KOK me vendim të veçantë.

Neni 61

Kostoja paraprake e pagesës së procedurës

1. Sekretari i Përgjithshëm i KAS-it do ta ftoj paditësin me një ftesë me shkrim për të paguar taksën, në afat prej 7 ditëve nga data e dorëzimit të padisë.
2. Nëse paditësi nuk paguan taksën brenda afatit të përcaktuar prej 7 ditësh, Sekretari i Përgjithshëm pret deri në 10 ditë tjera. Pas këtij afati, konsiderohet se Padia nuk është bërë fare.

Neni 62

Shpenzimet e tjera

1. Shpenzimet që lidhen me kryerjen e veprimeve procedurale të propozuara nga pala, sikurse kostot e ekspertizës, paraqitja e provave, mbulohen nga pala që propozon marrjen e tyre si dhe e njëjta detyrohet të depozitojë shumën e caktuar paraprakisht nga KAS.
2. Vendimin për pagesën e parapagimit për shpenzimet nga paragrafi 1 i këtij neni, e jep Arbitri individual apo kryesuesi i GjAS-it.
3. Nëse parapagimi i shpenzimeve nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është paguar, GjAS nuk do të ndërmerre veprimet e procedurale të propozuara nga pala.
4. Nëse shpenzimet e procedurës së Arbitrazhit nga paragrafi 1 i këtij neni janë sipas kërkesës ose me pëlqimin e të dy palëve, secila nga palët paguajnë gjysmën e paradhënies.
5. Të gjitha llojet e shpenzimeve të procedurës së Arbitrazhit do të përcaktohen me një vendim të veçantë të KAS.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 63

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për procedurat e Arbitrazhit të cilat janë iniciuar pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 64

Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare të KOK-ut dhe do të hyjë në fuqi ditën e radhës së punës pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOK.

Ismet Krasniqi

President i Komitetit Olimpik të Kosovës

Prishtinë, 7 Shkurt 2025